



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 87 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 16 / 06 / 2025

VENDIM

Nr.20, datë 16 /06 /2025

PËR

**PROBLEMATIKEN E FILTRIMEVE NË GALERINË E KONTROLLIT DHE
MONITORIMIT TË DIGËS SË HEC KOMAN**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 16.06.2025 mori në shqyrtim problematiken e filtrimeve në galerinë e kontrollit dhe monitorimit të digës së HEC Koman të paraqitur nga përfaqësuesi i KESH sh.a. Sipas KESH, kjo problematikë është shfaqur në Janar të vitit 2025 dhe aktualisht nga tavani i galerisë së pjerrët të kontrollit, në pjesën e poshtme të saj vërehen rrjedhje të ujtit në një sasi prej afro 4 l/s i cili rezulton të jetë në sasi konstante dhe i pastër.

Gjatë diskutimeve të antarëve të KKDM u vu theksin jo vetëm në rëndësinë e trajtimit me profesionalizëm të kësaj problematike të vecantë por edhe në emergjencën e një analize dhe studimi të thelluar nga ekspertë me eksperiencë në këtë fushë. Pas diksutimeve të antarëve të pranishëm KKDM,

VENDOSI:

- 1- Ti kërkoj KESH sh.a të vazhdoj monitorimin në kohë reale dhe online të filtrimeve të cfaqura në tavanin e galerisë së kontrollit dhe të monitorimit të digës së HEC Koman sipas Protokollit te monitorimit te paraqitur ne KKDM me një frekuencë te matjeve te sasise se rrjedhes se ujit prej jo me pak se 1 herë në orë. Ky monitorimi duhet të përqendrohet jo vetëm në sasinë e rrjedhës së ujit në galeri por edhe në monitorimin e eventeve sizmike, levizjeve të mundshme të masave shkëmbore në afërsi të digës, turbullsisë së ujit si dhe në mundësitë e cfaqjes së rrjedhjeve të ujit në të gjitha zonat e kësaj galerie. Në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në sasinë dhe turbullsinë e ujit, KESH sh.a duhet të dërgojë cdo 3 muaj në KKDM dhe në MIE një raport teknik në lidhje me rezultatet e monitorimit të këtyre rrjedhjeve si dhe të filtrimeve në zonën e poshtme të digës të shoqëruar me vizatimet teknike të galerisë se kontrollit, të digës në zonën e filtrimeve, analizat dhe konkluzionet përkatëse në lidhje me trendin e këtyre filtrimeve.
- 2- Ti kërkoj KESH sh.a dhe MIE kryerjen sa më shpejt të jetë e mundur të një analize dhe studimi të hollësishem të origjinës ë këtyre filtrimeve nga ekspertë me eksperiencë dhe të kualifikuar në sektorin e digave dhe të filtrimeve në to. Këto analiza dhe studime për origjinën e këtyre filtrimeve duhet të bazohen në rezultatet e monitorimit të kryera sipas protokollit të monitorimit nga KESH sh.a dhe të plotësohen dhe mbështeten në investigime të thelluara me metoda bashkëkohore si metoda të analizës elektromagnetike, metoda të përdorimit të izotopeve radioaktive, metoda të investigimit të detajuar nënujor, etj. KKDM mund të bashkëpunoj me KESH për preqatitjen e detyrës së projektimit për studimin në fjalë. Duke e konsideruar si një problem mjaft specifik në një objekt të rëndësishëm së vecantë dhe duke patur parash faktin se në vendin tonë nuk ka patur deri me sot një eksperiencë të ngjashme për studime të kësaj natyre, KKDM të sugjerojë që ky studim të kryhet nga ekspertë të huaj të kualifikuar dhe me eksperiencë në këtë fushë. KKDM mund të mbështet këtë proces përmes informacioneve dhe eksperiencave ndërkombëtare, organizimit të takimeve të punës me ekspertë dhe homologë të Komiteteteve të digave të vendeve të tjera me të cilat ka bashkëpunime institucional si në Francë, Zvicër, Itali, Spanjë, Japoni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 3- KKDM do të jetë e gatshme të shqyrtoj në një kohë sa më të shpejtë studimin që do të paraqitet nga KESH sh.a si shfrytëzues i kësaj dige. Studimi duhet të shoqërohet me studime dhe investigime shtesë mbështetëse gjeologjike, hidrogjeologjike, sizmike, etj dhe të japë një analize të plotë dhe të hollësishme për zgjidhjen e kësaj problematike.
- 4- KKDM të informoj MIE dhe Këshillin e Ministrave për gjëndjen aktuale të kësaj problematike të një rëndësie të vecantë dhe të sugjeroj marrjen e masave të duhura për zgjidhjen e kësaj problematike sipas sugjerimeve të mësipërme. KKDM sugjeron që zgjidhja e kësaj problematike duhet të konsiderohet emergjente dhe e një rëndësie të vecantë nga institucionet përkatëse. Gjatë vitit 2025 dhe deri në preqatitjen e studimit të mësipërm, një herë në cdo tre muaj, KESH duhet të preqatit dhe të dorëzoj në KKDM dhe MIE një raport teknik në lidhje me situatën e filtrimeve në digën e HEC Koman, rezultatet e monitorimit si dhe masat e marra për përmirësimin dhe kontrollin e situatës.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjisacionin në fuqi si dhe ndjekjen e detyrave të dhëna në këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI
Arjan JOVANI

